 Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC

  
REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE

 **SHDPAK**  
FONDACIONI  
SHQIPTAR  
PËR TË DREJTAT  
E PERSONAVE ME  
AFTËSI TË KUFIZUAR

 **United Nations**  
ALBANIA



Empowered lives.  
Resilient nations.

# PUNËSIMI



Leave  
No One  
Behind

@ UNDP


Tiranë, Korrik 2018

Autore: Sidita Fortuzi

Ndalohet shitja apo përdorimi i këtij udhëzuesi për qëllime përfitimi

Ky udhëzues u realizua përmes programit “Askush të mos mbetet pas”, financuar nga Agjencia Zviceriane për Zhvillim e Bashkëpunim, SDC, dhe zbatuar nga UNDP.

Mendimet e shprehura në këtë udhëzues u përkasin autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e UNDP.



**Seksioni “Punësimi” përmbledh legjislacionin që rregullon punësimin për personat me aftësi të kufizuara. Në këtë seksion gjendet informacion mbi:**

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 818, datë 26.11.2016 Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014 – 2020 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj

Fletore zyrtare Nr. 184

[http://www.qbz.gov.al/botime/fletore\\_zyrtare/2014/PDF-2014/188-2014.pdf](http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2014/PDF-2014/188-2014.pdf)

Ligji “Për nxitjen e punësimit” Nr. 7995, datë 20.09.1995 (i ndryshuar)

<http://www.vendime.al/wp-content/uploads/2017/05/Ligj-Nr.7995-dat%C3%AB-20.9.1995-Per-Nxitjen-e-Punesimit1.pdf>

Vendim nr. 248 “Për programin e nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuara”

Fletoren Zyrtare Nr.65, 12 maj 2014

[http://www.qbz.gov.al/Ligje.pdf/punesim/VKM\\_248\\_30042014\\_perditesuar.pdf](http://www.qbz.gov.al/Ligje.pdf/punesim/VKM_248_30042014_perditesuar.pdf)

Vendim Nr. 47, datë 16.1.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë”

Fletore Zyrtare Nr. 46, datë 02.04.2014 (botuar 08.04.2014)

[http://www.qbz.gov.al/botime/fletore\\_zyrtare/2008/PDF-2008/8-2008.pdf](http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2008/PDF-2008/8-2008.pdf)

Vendim Nr. 48 për masën dhe kriteret e përfitimit nga programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuësve të papunë në vështirësi

Fletore Zyrtare Nr. 46, datë 02.04.2014 (botuar 08.04.2014)

[http://www.qbz.gov.al/botime/fletore\\_zyrtare/2008/PDF-2008/8-2008.pdf](http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2008/PDF-2008/8-2008.pdf)

Vendim Nr.27, datë 11.1.2012 për programin e nxitjes së punësimit të grave dhe vajzave nga grupet e veçanta

[http://www.qbz.gov.al/Ligje.pdf/punesim/VKM\\_27\\_11012012\\_perditesuar.pdf](http://www.qbz.gov.al/Ligje.pdf/punesim/VKM_27_11012012_perditesuar.pdf)

Ligj Nr. 15/2017 datë 16.2.2017 Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë

<http://www.qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202017/Fletore%2043/LIGJ%20nr.%2015,%20date%2016.2.2017.pdf>

Plani Kombëtar i Veprimit për Persona me Aftësi të Kufizuara 2016-2020, Fletore Zyrtare Nr. 124, 7 Korrik 2016

[http://www.qbz.gov.al/botime/fletore\\_zyrtare/2016/PDF-2016/124-2016.pdf](http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2016/PDF-2016/124-2016.pdf)

Neni 27

Puna dhe punësimi

1. Shtetet Palë njohin të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për të punuar, njësoj si pjesa tjetër e popullsisë; këtu përfshihet e drejta për të patur mundësinë për të fituar jetesën duke bërë punë të zgjedhur lirisht apo të pranuar në tregun e punës dhe vendin/ambientin e punës që është i hapur, përfshirës dhe i arritshëm nga personat me aftësi të kufizuara. Shtetet Palë do të mbrojnë dhe inkurajojnë realizimin e të drejtës për punë, duke përfshirë dhe personat që e fitojnë aftësinë e kufizuar gjatë punësimit, duke marrë hapat e duhur, përfshirë masat ligjore me qëllim që ndër të tjera:
  - (a) të ndalojnë diskriminimin për shkak të aftësisë së kufizuar në të gjitha çështjet lidhur me punësimin, përfshirë kushtet e pajtimit në punë, punësimit, vazhdimësisë së punësimit, ecjes në karrierë dhe ofrimin e kushteve të sigurta dhe të shëndetshme të punës;
  - (b) të mbrojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, njësoj si gjithë të tjerët, duke përfshirë garantimin e mundësive të barabarta dhe pagesës të barabartë për punën me vlerë, siguri dhe kushte pune të shëndetshme të barabarta, duke përfshirë dhe mbrojtjen nga ngacmimet dhe zgjidhjen e ankesave;
  - (c) të garantojë që personat me aftësi të kufizuara të jenë në gjendje të ushtrojnë të drejtat e punës dhe të drejtat sindikaliste njësoj si gjithë të tjerët;
  - (d) të garantojë që personat me aftësi të kufizuara të kenë akses në programet e përgjithshme udhëzuese teknike dhe profesionale, në shërbimet e punësimit dhe për të garantuar trainim të vazhdueshëm dhe profesional;
  - (e) të nxitë mundësitë për punësim dhe karrierë për personat me aftësi të kufizuara në tregun e punës, si edhe ofrimin e asistencës për gjetjen, fitimin, mbajtjen dhe kthimin në punë;
  - (f) të nxitë mundësitë për vetëpunësim, aktivitet të lirë privat, zhvillimin e kooperativave dhe hapjen e një biznesi personal;
  - (g) të nxitë punësimin e personave me aftësi të kufizuara në sektorin publik;
  - (h) inkurajojë punësimin e personave me aftësi të kufizuara në sektorin privat nëpërmjet politikave dhe masave të duhura, të cilat mund të përfshijnë programe pozitive veprimi, stimuj dhe masa të tjera;
  - (i) të garantojë që personave me aftësi të kufizuara u sigurohet një akomodim i arsyeshëm në ambientin e punës;
  - (j) të inkurajojë personat me aftësi të kufizuara të fitojnë përvojë pune në tregun e hapur të punës;
  - (k) të promovojë programe për rehabilitim profesional, për mbajtjen e vendit të punës dhe ofrimin e programeve për kthimin në punë për personat me aftësi të kufizuara.
2. Shtetet Palë do të garantojnë që personat me aftësi të kufizuara të mos mbahen në skllavëri apo të përdoren si shërbëtorë dhe të jenë të mbrojtur ashtu si gjithë të tjerët nga puna e detyruar.

## Strategjia kombëtare për punësim dhe aftësim 2014-2020

### **Çfarë parashikon kjo strategji për personat me aftësi të kufizuara?**

- Strategjia përcakton personat me aftësi të kufizuara si një ndër grupet më të riskuara për përjashtim social.
- Ndër të tjerë grupe, fëmijët me aftësi të kufizuara kanë shkallën më të ulët të regjistrimit në shkollë, krahasuar me mesataren kombëtare.

### **Çfarë merr përsipër kjo strategji në lidhje me personat me aftësi të kufizuara?**

- Strategjia merr përsipër të përgjysmojë papunësinë e punëkërkuësve femra, duke përfshirë këtu femrat me aftësi të kufizuara dhe gjithashtu krijimin e aksesit të personave me aftësi të kufizuara në kurse të përshtatura të formimit profesional.
- Merr përsipër masa për të hequr pengesat me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara, të cilët përfitojnë nga Arsimi dhe Formimi Profesional si: mundësia e qasjes fizike në kurset e AFP-së, mungesa e instruktorëve të trajnuar, mungesa e materialeve të përshtatshme, informacioni i kufizuar, ngurrimi i kompanive si edhe i institucioneve publike për t'i punësuar ata, mungesa e shërbimeve shoqëruese mbështetëse, si dhe e personave që përkujdesen për to, bashkë me çështjet e transportit.
- Merr përsipër rritjen vjetore të raportit të personave me aftësi të kufizuara në AFP 1 pikë përqindje.
- Merr përsipër të rrisë numrin e përfituesve nga ndihma sociale të përfshirë te programet e nxitjes së punësimit në 10% të numrit total të pjesëmarrësve në programet e nxitjes së punësimit.

## Ligji “Për nxitjen e punësimit”

### **Çfarë rregullon ky ligj?**

Ky ligj përcakton që shërbimet e riaftësimi profesional janë të mundshme për të gjithë PAK, me kusht që ata të mund të përgatiten për to dhe të kenë perspektivë të arsyeshme për sigurimin dhe mbajtjen e punëve të përshtatshme.

### **Çfarë detyrimesh kanë punëdhënësit për punësimin e personave me aftësi të kufizuara?**

Ky ligj vendos edhe detyrimin që, çdo punëdhënës që punëson më tepër se 24 punonjës, është i detyruar të punësojë një person me aftësi të kufizuara për çdo 25 punonjës të personelit të tij.

Një punëdhënës mund të punësojë një person me handicap të rëndë në vend të pesë personave me handicap të lehtë.

Punëdhënësi mund të kërkojë subvencion nga zyra kompetente e punësimit (rajonale) për të pajisur siç duhet vendin e punës të personave me aftësi të kufizuara dhe për t'i siguruar atij/asaj një përgatitje thelbësore për punën.

Në zbatim të ligjit për nxitjen e punësimit janë miratuar edhe disa programe të veçanta të nxitjes së punësimit.

## **Vendim “Për programin e nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuara”**

### **Çfarë përfiton punëdhënësi që punëson një person me aftësi të kufizuara sipas këtij vendimi?**

Punëdhënësi fiton një financim mujor në masën deri në 100 për qind të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore, të pjesës së kontributit të punëdhënësit, me kusht që kohëzgjatja e kontratës së punës të mos jetë më e shkurtër se një vit.

Punëdhënësi gjithashtu përfiton një financim për të pajisur siç duhet vendin e punës/transport (përshtatja e arsyeshme) të personit me aftësi të kufizuar dhe për t'i siguruar atij/asaj një përgatitje thelbësore për punën deri në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë, por jo më shumë se 200 000 (dyqind mijë) lekë, nëse punëson më shumë se dy persona.

### **Kush mund të aplikojë për të përfituar nga ky program?**

Të gjithë punëdhënësit, fizikë apo juridike.

### **Çfarë kriteresh duhet të plotësojnë këta punëdhënës?**

Nuk duhet të kenë shkelur legjislacionin e punës.

Duhet të jenë të rregullt në shlyerjen e detyrimeve tatimore, sigurimet e detyrueshme shoqërore përgjatë veprimtarisë së tyre.

Çfarë përfiton personi i punësuar me aftësi të kufizuar?

Personi përfiton pagë minimale për gjashtë muajt e parë të punësimit

Personit përfiton gjysëm e pagës minimale për gjashtë muajt e dytë të punësimit.

### **A e humb pagesën për shkak të aftësisë së kufizuar?**

Për 4 vite personi nuk e humbet pagesën për shkak të aftësisë së kufizuar, në bazë të Ligjit Nr. 9355, datë 10.03.2005, i ndryshuar.

Po për formimin në punë a ka nxitje?

Po. Zyra e punësimit financon për formimin në punë të personave me aftësi të kufizuara.

### **Çfarë përfiton punëdhënësi duke marrë në kurse formimi profesional persona me aftësi të kufizuara?**

Punëdhënësi përfiton deri në 70% të tarifës së kostos së trajnimit

### **Sa zgjat formimi në punë?**

Formimi nuk mund të zgjasë më shumë se 6 muaj.

## **A ka detyrime punëdhënësi në përfundimi të trajnimit?**

Po. Ka detyrimin të punësojë jo më pak se 30% të pjesëmarrësve në formim.

## **Çfarë përfitojnë personat me aftësi të kufizuara duke ndjekur këto kurse?**

Formim profesional

Pagesë deri në masën 50% të pagës minimale

Sigurime të paguara për mbrojtje nga aksidentet në punë

\*Por personat me aftësi të kufizuara mund të përfitojnë edhe nga programe të tjera, megjithëse

Vendimi 248 është më i plotë dhe i volitshëm.

### **Vendim “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë”**

## **Sa është kohëzgjatja e këtij programi?**

Kohëzgjatja e tij është 6 muaj.

## **Çfarë përfitimesh ka punëdhënësi?**

Punëdhënësi, që organizon trajnim të përgjithshëm, për qëllim formimi, nëpërmjet punës së personave punëkërkues të papunë, mund të përfitojë financime nga zyra përkatëse e punësimit, në masën 70 për qind të kostove të trajnimit, për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe 50 për qind të kostove të trajnimit, për ndërmarrjet e mëdha.

## **Çfarë detyrimesh ka punëdhënësi pas përfundimit të formimit në punë?**

Punëdhënësi, në përfundim të periudhës së formimit, duhet të punësojë jo më pak se 50 për qind të të trajnuarve, me kontratë mësimi profesioni, për një periudhë 6-mujore.

## **Çfarë përfitojnë kursantët?**

Kursantët, punëkërkues të papunë, përfitojnë një pagesë pjesëmarrjeje në kurs, në masën 50 për qind të pagës minimale, në shkallë vendi, për të gjithë kohëzgjatjen e trajnimit, e cila përballohet nga zyra përkatëse e punësimit, nga fondet e nxitjes së punësimit.

### **Vendim “Për masën dhe kriteret e përfitimit nga programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë në vështirësi”**

## **Çfarë parashikon ky vendim?**

Punëdhënësi, që punëson me kontratë, me kohëzgjatje njëvjeçare, punëkërkues të papunë në vështirësi (sipas përcaktimit në ligj, të tillë janë dhe personat me aftësi të kufizuara), mund të përfitojë një financim për një vit, në masën 100 për qind të sigurimeve të detyrueshme shoqërore të pjesës së punëdhënësit

dhe një financim për katër muaj, në masën 100 për qind të pagës minimale në shkallë vendi, duke filluar nga muaji i nëntë, për të gjithë vitin e zbatimit të kontratës dhe gjithashtu deri në 50 për qind të numrit mesatar të të siguruarve të 3 muajve të fundit përpara aplikimit.

### **Vendim “Për programin e nxitjes së punësimit të grave dhe vajzave nga grupet e veçanta”**

#### ***Kush përfiton nga ky program?***

Përfituesit e këtij programi janë gra kryefamiljare dhe vajza nëna, të cilat kanë në ngarkim fëmijë nën moshën 18 vjeç.

#### ***Çfarë përfitojnë?***

Deri në gjashtë paga, në masën 115 për qind të pagës minimale në shkallë vendi, në muajin e katërt, të pestë, të gjashtë e të shtatë dhe në muajin e njëmbëdhjetë e të dymbëdhjetë të kontratës. Ndërsa, për muajt e tjerë, financon punëdhënësi.

Zyra përkatëse e punësimit financon punëdhënësin, me një financim mujor në masën deri në 100 për qind të kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore (pjesë e kontributit të punëdhënësit), me kusht që kohëzgjatja e kontratës së punës të mos jetë më e shkurtër se një vit.

Punëdhënësit e rinj, persona juridikë apo fizikë, kanë të drejtë të kërkojnë të përfshijnë në program deri në 40 për qind të numrit të punonjësve të punësuar.

### **Ligj “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”**

#### ***Cili është qëllimi i këtij ligji?***

Ky ligj ka për qëllim të krijojë dhe të zhvillojë një sistem të njësuar të arsimit dhe formimit profesional që t’u përgjigjet ndryshimeve socialekonomike dhe teknologjike, në përputhje të plotë me nevojat e tregut vendas e global të punës e të garantojë mundësi të barabarta për të gjithë individët që duan të ndjekin studimet në AFP.

#### ***Çfarë qëllimi ka arsimit dhe formimi profesional?***

Arsimi dhe formimi profesional ka për mision të zhvillojë kompetenca personale e profesionale të nevojshme, si dhe shprehje e kompetenca të tjera të diversifikuara, që pasqyrojnë preferencat dhe nevojat e veçanta të punëdhënësve për të siguruar mirëqenie sociale dhe zhvillimin ekonomik dhe të ofrojë arsim dhe formim profesional në përputhje me nivelin e zhvillimit të shkencës e të teknologjisë, me kërkesat e tregut të punës në ndryshim të vazhdueshëm, si dhe me kulturën e traditën kombëtare.

#### ***Si përfitojnë nga ky ligj personat me aftësi të kufizuara?***

Parimi i gjithëpërfshirjes në sistemin e arsimit dhe formimit profesional ofron mundësi arsimimi dhe formimi profesional për të gjithë, pa asnjë diskriminim.



Parimi i garantimit të pjesëmarrjes garanton që sistemi i arsimit dhe formimit profesional krijon kushtet financiare, fizike dhe shoqërore për individët për të përfituar nga mundësitë e të nxënësve gjatë gjithë jetës.

Parimi i diversitetit garanton që sistemi i AFP-së ofron lloje dhe nivele të shumëllojshme të kualifikimeve, të përshtatura për grupe të ndryshme, duke njohur njohuritë e tyre të përfutuara më parë.

Një tjetër mundësi që ofron ligji janë bursat, pra financim monetar që jepet për të mbështetur arsimimin e një nxënësi për arritjet mësimore. Llojet e bursave janë: bursat e studimit për nxënësit me arritje mësimore, bursat e studimit për nxënësit që ndjekin drejtime profesionale që janë prioritet kombëtar ose vendor, bursat e studimit për studentët që u përkasin shtresave sociale në nevojë.

Pushteti vendor gjithashtu mund të ofrojë bursa për të ndjekur AFP-në në bashki të tjera në profile që përputhen me prioritetet vendore, sipas udhëzimit përkatës të ministrit përgjegjës për pushtetin vendor.

## **Plani Kombëtar i Veprimit për PAK, punësimi**

### ***Çfarë ka marrë përsipër Plani Kombëtar i Veprimit për PAK në lidhje me punësimin?***

Plani Kombëtar merr përsipër që të rrisë pjesëmarrjen në tregun e punës dhe promovimin e mundësive të barabarta për punë të denjë për personat me aftësi të kufizuara.

Qeveria merr përsipër të përmirësojë cilësinë dhe shtrirjen e shërbimeve të arsimit dhe formimit profesional që nxisin përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës.

Qeveria merr përsipër të lehtësojë integrimin e personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës nëpërmjet programeve të nxitjes së punësimit.

Qeveria merr përsipër të përmirësojë cilësinë dhe efikasitetin e institucioneve dhe shërbimeve të punësimit që synojnë nxitjen e integritit të personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës.

